

buletiniinfo

Buletin informativ mujor
Nëntor, 2022



FILLON IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT PËR PASTRIMIN E LAGJËS ALI IBRA



Deputeti Fridon Lala
diskuton për buxhetin e
viti 2023



Hapet konkursi për 100
bursa për studentët e viti
té parë



Tri shtëpi për familje
skamnore në Pejë



RESHJET E SHUMTA TË SHIUT PO SHKAKTOJNË PROBLEME TË VAZHDUESHME TË KOMUNITETIT

Reshjet e shumta të shiut që janë të shpeshta gjatë kësaj vjeshte po shkaktojnë vërshime për shkak të volumit të reshjeve dhe për shkak të infrastrukturës së dobët për të përballuar këto sfida. Komuniteti Egjiptian për shkak të pozitës së vendbanimeve ku jeton, është shndërruar në cak të vërshimeve të cilat përpos që po e rrezikojnë jetën e tyre po iu shkakton dëme materiale dhe shqetësimë të vazhdueshme.

Me datën 20 Nëntor të këtij viti, Ministri i MAPL-së Elbert Krasniqi u taku me disa Kryetarë të Komunave me të cilët ka biseduar lidhur me situatën aktuale.

Gjithashtu, ka vizituar disa nga lokacionet të cilat kanë pësuar dëme si ura në Vranoc e cila lidh Pejën dhe Deçanin dhe e cila është dëmtuar si pasojë e këtyre vërshimeve.

Së bashku me ministrin Elbert Krasniqi jemi duke përcjellur situatën me vërshime pas reshjeve të shumta të shiut në disa lokacione, të banuara nga komunitetet, Bashkësinë Lokale Xhemajl Kada dhe 7 Shtatori në Pejë.



FILLON NDËRTIMI I TRI SHTEPIVE PËR FAMILJET SKAMNORE NË PEJË

Në bashkëfinancim të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe Bashkimit Europian në Kosovë, ka filluar ndërtim i tri shtepive në Pejë. Përfitues janë dy familje nga komuniteti egjiptian dhe një nga komuniteti rom. Zbatuese e këtij projekti është Organizata Ndërkombëtare për Migracion(IOM).





NDAHET NGA JETA VEPRIMTARI SHUMËVJEÇAR I IRDK-SË SELMAN SHABANAJ

Me datën 1 Nëntor të këtij viti u nda nga jeta veprimtari shumëvjeçar i IRDK-së, Selman Shabanaj nga komuna e Istogut.

Selman Shabanaj është bashkuar me veprimtarët e parë të IRDK-së. Në vitin 1999/2000, për të qenë pranë komunitetit, fillimisht për të qenë të sigurt dhe për tu kthyer ata që u zhvendosen dhe pastaj për të përmirësuar kushtet e jetës së komunitetit në komunën e Istogut. Selmani ishte i zëshëm në kërkesat e komunitetit të Dragolevcit të cilin e përfaqësoj dhe bëri shumë mund dhe punë të mira për të përmirësuar infrastrukturën e banorëve të Dragolevcit, Istogut të Poshtëm dhe Muzhevinës.

Kryetari Elbert Krasniqi e ngushëlloi familjen Shabanaj dhe degën e IRDK-së në Istog. Me rastin e ndarjes nga jeta të Selman Shabanaj, veprimtar i ditëve të para të IRDK-së në Istog, shpreh ngushëllime familjes Shabanaj dhe degës së IRDK-së n Istog.

Selman Shabanaj do të mbetet përgjithmonë në kujtimet tona si aktivist i përkushtuar i IRDK-së dhe do të na shërbej si motiv për punë dhe përkushtim.



DEPUTETI FRIDON LALA DISKUTON NË PARLAMENTIN E KOSOVËS PËR BUXHETIN E VITIT 2023

Sot po e diskutojmë njërin prej ligjeve më imperativë për vitin e ardhshëm kalendarik Ligjin për ndarjet buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës përmes të cilët orientojmë punët dhe projektet konkrete të cilat synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Mbi këtë premisë, përtej problemeve të shumta sociale po besoj se projektligji inkorporon interesat e qytetarëve, e si përfaqësues i komunitetit Egjiptian mund të them edhe nevojat të cilat janë më imediate të komunitetit që përfaqësojnë mirëpo edhe të grupeve tjera në nevojë. Normalisht përderisa diskutojmë për ndarjet buxhetore për vitin që po vije reflektojmë edhe në praktikat, politikat dhe projektet konkrete të cilat janë realizuar në vitin që po lemë pas.

Komuniteti Egjiptian në kushte të renduara ekonomike, si pasojë e eventeve të ndryshme globale ka qenë përfitues në masë të kënaqshme e projekteve apo pakove fiskale të dizajnuara për ti dalë në ndihmë grupeve të ndryshme shoqërore në Kosovë.



Po ashtu çka është tepër e rëndësishme për ne është që kemi arritur që të inkorporojmë në buxhetin e viti 2023 dy projekte tepër vitale për komunitetin që përtej rëndësisë dhe nevojës për investime pasqyrojnë edhe të drejtën bazike të tyre për të pas qasje në ujë të pijes dhe po ashtu për të jetuar në ambient të pastër. Në Ali Ibra në Gjakovë po vazhdojnë punimet për rregullimin dhe rehabilitimin e deponisë ilegale për dërgimin e mbeturinave dhe jemi të kënaqur që në buxhetin e viti 2023 është ndarë shumë po ashtu që pas pastrimit të lagjes të kemi edhe ambiente rekreative për qytetarët të cilët jetojnë në atë zonë. Po ashtu pas kalkulimeve të gabuara komunale për vitin e kaluar për buxhetin e viti 2023 kemi arritur ti ndajmë 3 milion euro për shtrirje e rrjetit të ujit të pijes në lagjet 28 dhe 29 të komuniteteve në Fushë Kosovë dhe po ashtu edhe për fshatrat për rreth. Këto janë dy prej projekteve kryesore për të cilat kemi qenë të zëshëm edhe gjatë viti të kaluar por edhe gjatë këtij viti. Përtëj këtyre dy projekteve vlen të theksohet se në Buxhetin e viti 2023 kemi po ashtu ndarje apo buxhetime për dy fusha tjera të rëndësishme, njëra prej tyre është arsimi ku për herë të parë në histori kemi

planifikim buxhetor për përkrahje të studenteve nga radhët e komuniteteve Egjiptian, Ashkali dhe Rom për ti përkrahur me bursa për ndjekjen e arsimit të lartë. Po ashtu në fushën e banimit, në koordinim me ministrat e ministritive të linjës 3 milion euro janë ndarë për rregullimin e dhe rehabilitimin e shtëpive të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe po ashtu 2 milion tjera janë të ndara për projekte të banimit social. Dhe së fundmi jemi gjithashtu të lumtur që vazhdon përkrahja e projektit për investime infrastrukturore për lagjet ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna të ndryshme të Kosovës përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për shkak se vitin që po e lemë pas kemi adresuar një gamë të gjerë të problemeve infrastrukturore të cilat kanë qenë të grumbulluara ndër vite në ato lagje ku komunitetet jo shumicë janë të koncentruara dhe po besoj se me ndarje të reja buxhetore për vitin që po vije do të kemi po ashtu rregullim të një pjese të madhe të problemeve infrastrukturore të cilat janë mbetur në këto lagje.



HAPET KONKURSI PËR 100 BURSA PËR STUDENTET E VITIT TË PARË NGA RADHËT E KOMUNITETEVE EGJIPTIAN, ASHKALI DHE ROM

Pas nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Ministren së Arsimit, Arbërie Nagavcin, dhe Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, është hapur konkursi për përfitimin e bursave për 100 studentë nga radhët e komuniteteve Egjiptian, Ashkali dhe Rom. Fillimisht kjo thirrje është destinuar për Fakultetin e Edukimit, mirëpo për arsyet të numrit të ulët të aplikuesve, tashmë konkursi është për të gjitha drejtimet në të gjitha universitetet publike për studentet e komuniteteve Egjiptian, Ashkali dhe Rom të cilët sivjet janë regjistruar në vitin e parë të studimeve.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që përmes bursave dhe mekanizmave të tjera të fuqizojë gjeneratat e reja të edukatorëve dhe mësimdhënësve nga radhët e komuniteteve.

IRDK si pjesë e Qeverisë i ka dhënë pripritet arsimimit të gjeneratës së re duke bërë përpjekje që mësimdhënësit e komunitetit Egjiptian të jenë në numër më të madh në shkollat në gjuhën shqipe ku edhe nxenësitë e komunitetit Egjiptian e vijojnë mësimet.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, nga data **18.11.2022** deri më **02.12.2022**, në ora 16:00.

Shuma maksimale e bursës do të jetë deri në 1,000€ për studentët përfitues.

Aplikimi bëhet përmes platformës e-Kosova.



FILLON IMPLEMENTIMI PËR PASTRIMIN E DEPONISË SË MBETURINAVE NË LAGJEN ALI IBRA

Me datën 01.11.2022, në lagjen Ali Ibra në Gjakovë, filloj faza e parë e rehabilitimit të deponisë ilegale afër stacionit transfer.

Zgjidhja e këtij problemi është e rëndësishme për mirëqenien e banorëve të lagjes Ali Ibra si dhe për qytetin e Gjakovës.

Pastrimi i kësaj zone është faza e parë e projektit për të vijuar me rehabilitim, ku do krijohet parku në këtë hapësirë.

Kjo lagje në komunën e Gjakovës, e banuar kryesisht nga komuniteti Egjiptian, prej vitesh është shndërruar në deponi të mbeturinave të qytetit të Gjakovës. Edhe pse e projektuar si stacion transfer i mbeturinave, ky lokacion për vite të tera mbetet i sterngarkuar nga mbeturinat e qytetit. Stacioni transfer nënkuption zbrazen e përkohshme të mbeturinave dhe transferimi i tyre në deponinë në Landovicë por si i tillë asnjëherë nuk është përdorur duke krijuar kushte të vështira për banorët e kësaj lagje.

E iniciuar nga ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi ky projekt ka filluar që sivjet të implementohet por finalizimi i këtij projekti nuk do të ndodh në këtë vit por do të vazhdohet edhe vitin e ardhshëm me qëllim të kthimit të vendit të mbeturinave në hapësira të gjelbërta.



Pamje nga fillimi i punimeve në lagjen Ali Ibra në Gjakovë



Stacioni transfer i mbeturinave në lagjen Ali Ibra në Gjakovë



MBAHET SAMITI I BALLKANIT PËRENDIMOR KUNDËR DISKRIMINIMIT RACOR

Ma datën 07.11.2022, në Prishtinë është organizuar Samiti i Ballkanit Perëndimor kundër diskriminimit racor. Samiti është mbajtur për dy ditë ku është diskutuam për shumë tema të cilat kanë të bëjnë me diskriminimin racor, angazhimin për përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të komuniteteve Egjiptian, Ashkali dhe Rom dhe përfaqësimin e këtyre komuniteteve në edukim dhe arsim.

Në panelin e diskutimit për luftimin e diskriminimit racor si faktor në procesin e para-antarësimit në BE, ka marrë pjesë edhe Mnistri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Elbert Krasniqi i cili ndër të tjera ka përmendur angazhimin e përditshëm të ministrisë për barazi dhe dinjitet, për kushte më të mira socio-ekonomike dhe për mbrojtjen nga diskriminimi racor duke synuar që së bashku të jemi të barabartë.

Në këtë samit ka marrë pjesë edhe Kryeministri i Republikë së Kosovës, Albin Kurti, Zëvendëskryeministrja, Emilia Redzhepi, përfaqësues diplomatik nga ambasadat në Kosovë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues institucional nga vendi dhe rajoni.




MINISTRI ELBERT KRASNIQI VIZITON KOMUNËN E MITRIVICËS

Me datën 15.11.2022, Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka vizituar komunën e Mitrovicës. Ministri ka takuar Kryetarin e Komunës, Bedri Hamza, me të cilin ka diskutuar për procesin e implementimit të projekteve komunale, zhvillimin ekonomik lokal dhe mundësitë për bashkëpunim në mënyrë që të ofrohen shërbime sa më cilësore për qytetarët.

Ministri Elbert Krasniqi në këtë rast vizitoj në terren implementimin e projektit "Rregullimi dhe riparimi i rrugës Mbretëresha Teutë", e financuar nga Granti i Performancës dhe punimet në shkollën fillore "Bedri Gjinaj", për termoizolimin dhe zëvendësimin e dritareve të shkollës, e financuar nga instrumenti për projekte infrastrukturore për komunitetet.

Në të njëjtën ditë Ministri Elbert Krasniqi, bashkë me zëvendëskryesuesin, Skender Sadiku, në Mitrovicën e Veriut, vizituan objektin e Komunës së Mitrovicës së Veriut, dhe zyrën e gjendjes civile për të parë mbarëvajtjen e shërbimeve për qytetarët.



RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E LIPJANIT

Në Komunën e Lipjanit, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira infrastrukturore për qytetarët dhe me synim të zhvillimit të lagjeve të banuara nga komunitetet, MAPL ka financuar disa projekte kapitale.

Nga programi për projekte infrastrukturore në komunitete Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e udhëhequr nga Ministri Elbert Krasniqi, ka financuar projektin 'Asfaltimi i rrugëve në Lipjan dhe Hallaq i vogël' dhe nga instrumenti për investime kapital ka financuar projektin 'Rregullimi i hapësirave publike në Komunën e Lipjanit'.

Bashkëpunimi do të vazhdoj dhe përkrahja nuk do të mungojë, drejt zhvillimit ekonomik lokal dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve ka theksuar Ministri Elbert Krasniqi.



ASFALTIMI I RRUGËS DHE TROTUARIT NË DUBRAVË TË KOMUNËS SË FERIZAJIT

Vazhdon financimi i projekteve komunale për zhvillimin e infrastrukturës në lagjet dhe fshatrat e banuara nga komunitetet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Në Komunën e Ferizajit, nga programi për projekte infrastrukturore në komunitete Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka financuar projektin 'Asfaltimi i rrugës dhe trotuarit në fshatin Dubravë', i banuar nga komuniteti Ashkali, duke synuar që banorët e këtij fshati t'i mbështesim me investime kapitale.

Ky projekt është vetëm një nga shumë projekte të tjera në mbështetje të Komunave dhe në shërbim të qytetarëve nga Ministria e drejtuar nga Ministri Elbert Krasniqi.



NDËRTIMI I RRUGËS DHE INFRASTRUKTURËS NËNTOKËSORE NË FSHATIN DRESNIK DHE SHTUPELL

Vazhdon financimi i projekteve komunale nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zhvillimin e infrastrukturës në lagjet dhe fshatrat e banuara nga komunitetet.

Ministria e udhëhequr nga Ministri Elbert Krasniqi, në Komunën e Klinës ka financuar projekte nga programi për projekte infrastrukturore në komunitete. Në kuadër të kësaj kategoria është financuar projekti 'Ndërtimi i rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore në fshatin Dresnik dhe Shtupell', i cili është duke u implementuar nga Komuna e Klinës.



IMPLEMENTOHET PROJEKTET E FINANCUARA NGA MAPL NË KOMUNËN E ISTOGUT

Vazhdon financimi i projekteve komunale të finançuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e udhëhequr nga Ministri Elbert Krasniqi, për zhvillimin e infrastrukturës në lagjet dhe fshatrat e banuara nga komunitetet.

Në Komunën e Istogut, nga programi për projekte infrastrukturore në komunitete kemi finançuar projektin 'Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugën 7 Marsi në Gurrakoc, rrugën 24 Qershori në Zallq - lagjën e epërme, asfaltimin e rrugës Sadri Lata në Zallq dhe ndërtimin e rrugës lagjja "Maksutaj" Orrobërdë'.



ASFALTIMI I RRUGËS NË LAGJËN SADRIJAJ NË KOMUNËN E DEÇANIT

Vazhdon financimi i projekteve komunale për zhvillimin e infrastrukturës në lagjet dhe fshatrat e banuara nga komunitetet.

Në Komunën e Deçanit, nga programi për projekte infrastrukturore në komunitete kemi financuar projektin për asfaltimin e rrugës "Sadrijaj" në Gramacel.

buletini info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione
Kulturë
Histori
Shkencë

Dërgoni në email: **buletini.info@gmail.com**